



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-14
Prishtinë, më 26 shkurt 2015,

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 26 SHKURT 2015

Seancën e drejtoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmuan: Xhavit HALITI, dhe Sabri HAMITI, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare dhe procedoi me pikat si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Sala Berisha-Shala, Besa Gaxherri, Salih Salihu, Donika Kadaj-Bujupi, Qerim Bajrami, Zafir Berisha, Emilija Rexhepi, Adem Salihaj, Shaip Muja, Vjosa Osmani, Selvije Halimi, Haxhi Shala, Margarita Kadriu-Ukelli, Visar Ymeri, Shpejtim Bulliqi, Veton Berisha, Synavere Rysha, Enver Hoti dhe kryeministri Isa Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Ismajl Kurteshi e kishte tërhequr pyetjen parlamentare, të bartur nga seanca plenare e datës 5 shkurt 2015, për ministrin Lubomir Mariq lidhur me njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe në vend të saj për këtë seancë kishte parashtruar pyetje për ministrin Arban Abrashi lidhur me pagesën e pensioneve të qytetarëve të Kosovës që i kanë realizuar të drejtën e pensionet në Zvicër, por në mungesë të ministrit, e shtyu për mbledhjen e radhës.

Deputeti Daut Haradinaj, parashtrroi pyetje për ministrin, Skender Hyseni në lidhje me atë se ndaj sa zyrtarëve policorë janë marrë masa, apo hetime, kush po i zhvillon këto hetime dhe kur pritet një raport final i situatës për ngjarjet e protestës së mbajtur më 27 janar 2015.

Ministri Skender Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Pal Lekaj, parashtroi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me masat e ndërmarra lidhur me vërshimet e fundit në Kosovë.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Pal Lekaj, parashtroi pyetje për ministrin Avdullah Hoti në lidhje me kohën se kur pritet zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me pagesën për punëtorët e Fabrikës së Tubave në Ferizaj.

Ministri Avdullah Hoti nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Time Kadrijaj, parashtroi pyetje për ministrin, Skender Hyseni në lidhje me arsyet e heqjes dorë nga shtetësia e Kosovës, të qytetarëve të vendit dhe sa është numri i tyre.

Ministri Skender Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Rustem Berisha, parashtroi pyetje për ministrin, Haki Demolli, në lidhje me transformimin e FSK-së, në Ushtri të Kosovës dhe kur pritet procedimi në Kuvend i Projektligjit për Forcat e Armatosura të Kosovës.

Ministri, Haki Demolli iu përgjigj pyetjes së deputetit Rustem Berisha.

Deputeti Rafet Rama, parashtroi pyetje për ministrin, Ferid Agani, në lidhje me derdhjen e kemikaleve të kombinatit “Trepça” në lumin Trepça, vlerësimet e Inspektoratit të Mjedisit për këtë çështje dhe masat eventuale ndaj përgjegjësve.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Rafet Rama.

Deputetja Teuta Haxhiu, parashtroi pyetje për kryeministrin, Isa Mustafa, në lidhje me atë se në takimin e mbajtur më 9 shkurt 2015 në Bruksel, ndërmjet dy kryeministrave, të Kosovës dhe atij të Serbisë, a ishte temë e bisedimeve çështja e të pagjeturve.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Bekim Haxhiu, parashtroi pyetje për ministrin, Arsim Bajrami, në lidhje me hapat konkret të ndërmarrë nga Ministria e Arsimit, në lidhje me zgjidhjen e problemit të peshës së çantave të nxënësve.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

Deputeti Bekim Haxhiu, parashtroi pyetje për ministrin, Imet Rrahmani, në lidhje me, siç tha ai, nivelin e lartë të falsifikimit dhe kontrabandimit të barnave, për arsyet e shkarkimit të kryeinspektorit farmaceutik, Basri Rexha dhe cilat janë veprimet ligjore që ka ndërmarrë Ministria e Shëndetësisë ndaj shkelësve të ligjit?

Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Teuta Rugova, parashtroi pyetje për zv/kryeministrin, Kujtim Shala, në lidhje me rezultatet e arritura që dalin nga Strategjia për rini 2013 – 2015 dhe a do të ketë hapa shtesë në planin e veprimit për këtë vit?

Zv/kryeministri Kujtim Shala iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Rugova.

Deputeti Nuredin Ibishi, parashtroi pyetje për ministrin, Imet Rrahmani, në lidhje me ndërmarrjen e masave për vetëdijesimin e qytetarëve lidhur me masat preventive mjekësore dhe zgjerimin e kapaciteteve në nivel primar, sekondar dhe terciar.

Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Mytaher Haskuka, parashtroi pyetje për ministrin, Arban Abrashi, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve konkrete në lidhje me largimet e punëtorëve nga puna në korporata të mëdha në Kosovë, me theks të veçantë në lidhje me reduktimin e më shumë se 10 % të tyre nga ana e një banke në Kosovë.

Ministri Arban Abrashi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Aida Dërguti, parashtroi pyetje për kryeministrin, Isa Mustafa, në lidhje me mospublikimin e vendimit për shkarkimin e ish-ministrit Jablanoviq.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Besa Baftiu, parashtroi pyetje për ministrin, Imet Rrahmani, në lidhje me mungesën e citostatikëve në QKUK.

Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Visar Ymeri, parashtroi pyetje për ministrin, Blerand Stavileci, në lidhje me çmimin e projektit për termocentralin “Kosova e Re” dhe çfarë norme të kthimit të investimeve ka kërkuar kompania amerikane “Contour Global”.

Ministri Blerand Stavileci nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albulena Haxhiu, parashtroi pyetje për ministrin, Hajredin Kuçi, në lidhje me atë se çka përmbajnë dokumentet që kanë të bëjnë me formimin e Gjykatës Speciale dhe cili është formati i ardhshëm ligjor për këtë gjykatë?

Ministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Arben Gashi, parashtroi pyetje për ministrin, Imet Rrahmani, në lidhje me masat e ndërmarra për mbrojtjen e interesit publik dhe të QKUK-së për parandalimin e hapjes së spitalit privat “Spitali Amerikan”, në hapësirën e QKUK-së dhe si do të vepohet në këtë rast specific?

Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Time Kadrijaj, parashtroi pyetje për ministrin, Arban Abrashi, në lidhje me fillimin e implementimit të Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Ministri Arban Abrashi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Alma Lama, parashtroi pyetje për ministrin, Memli Krasniqi, në lidhje me kompensimin e dëmeve nga ana e shtetit, për bujqit, të cilët kanë pësuar nga fatkeqësitë natyrore dhe kur pritet të krijohet ndonjë fond i veçantë për këtë çështje.

Ministri Memli Krasniqi iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Alma Lama, parashtroi pyetje për zv/kryeministrin, Kujtim Shala, në lidhje veprimet e Ministrisë së Kulturës, për kthimin e artefakteve në Kosovë. A është e pranueshme që për këtë grabitje të Serbisë, tani të negociohet me shtetin serb në Bruksel dhe cili është qëndrimi i UNESCO-s, në lidhje me këtë çështje?

Zv/kryeministri Kujtim Shala iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputeti Zafir Berisha, parashtroi pyetje për ministrin, Ferid Agani, në lidhje numrin e deponive të mbeturinave të cilat i plotësojnë kushtet, menaxhimin e tyre dhe a janë deponitë në gjendje për ta kryer funksionin e tyre?

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Zafir Berisha.

Deputetja Vjosa Osmani, parashtoi pyetje për ministrin, Mahir Yagcilar, në lidhje atë se a po e shfrytëzon ndonjë deputet i Kuvendit të Kosovës ndonjë veturë të Qeverisë (me regjistrim 3Z) për qëllime zyrtare ose private. Cila është baza ligjore e cila e lejon këtë çështje?
Ministri Mahir Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Vjosa Osmani.

Deputeti Bali Muharremaj, parashtoi pyetje për kryeministrin, Isa Mustafa, në lidhje me krijimin e Fondit për pengimin e migrimit ilegal.
Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Bali Muharremaj, parashtoi pyetje për kryeministrin, Isa Mustafa, në lidhje me veprimet konkrete të Qeverisë për zhvillimin ekonomik dhe për hapjen e vendeve të reja të punës, në mënyrë që të ndërpritet sadopak migrimi ilegal i qytetarëve.
Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, parashtoi pyetje për kryeministrin, Isa Mustafa, në lidhje me veprimet konkrete, për realizimin e çështjeve nga programi zgjedhor i partisë që ai drejton, të cilat kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë dhe sigurisë si dhe reformimin e organit të akuzës.
Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Rexhep Selimi, parashtoi pyetje për kryeministrin, Isa Mustafa, në lidhje me veprimet e Qeverisë, në mënyrë që qytetarët e vendit të kenë perspektivë dhe shpresë për një jetesë më stabile ekonomike.
Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Visar Ymeri, parashtoi pyetje për kryeministrin, Isa Mustafa, në lidhje me zotimin për të aprovuar Ligjin për “Trepçën”, ngase siç dihet, më 21 janar 2015, minatorët e “Trepçës” kanë pezulluar grevën e tyre, me kushtin siç tha ai, që pas një muaji Qeveria e Kosovës të miratojë ligjin për “Trepçën”.
Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Glauk Konjufca, parashtoi pyetje për zv/kryeministrin, Hashim Thaçi, në lidhje me hapat e ndërmarrë për përmbushjen e rekomandimeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, më 1 mars 2012, të propozuara nga GP i Lëvizjes “Vetëvendosje”.
Zv/kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Fisnik Ismajli, parashtoi pyetje për ministrin, Skënder Hyseni, në lidhje me atë se çka nënkupton plani operativ i Policisë së Kosovës “Proçka” dhe pse është toleruar bllokimi i rrugës, më 22 shkurt 2015, që shpie në qendrat turistike Prevallë dhe Brezovicë dhe kërkimi i të hollave nga persona të nacionalitetit serb në komunën e Shterpçës.

Ministri Skënder Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Salih Salihu, parashtoi pyetje për ministrin, Lutfi Zharku, në lidhje me atë se çka nënkupton revitalizimi i rrugës Viti –Gërlicë dhe Viti – Kllokot, të cilat janë paraparë në kuadër të zërit buxhetor për revitalizimin e infrastrukturës rrugore.
Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetit Salih Salihu.

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Propozimi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
5. Propozimi për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
6. Formimi i Komisionit Ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Kuvendi miratoi pa asnjë vërejtje procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 12 e 13 shkurt 2015.

4. Propozimi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kryesuesi Sabri Hamiti, ftoi kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

Deputetja Albulena Haxhiu tha se si Komision kemi shqyrtuar propozimin për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit i kemi rekomanduar emërimin e kandidatëve si në vijim:

1. Nehat Idrizi, Gjykata Themelore në Prishtinë,
2. Armend Berisha, Gjykata Themelore në Pejë, dhe
3. Gjimeshit Galushi, Gjykata Themelore në Prizren.

Fjala e Albulena Haxhiut është dhënë e plotë në transkript.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Selvije Halimi - në emër të GP të PDK-së, Armend Zemaj - në emër të GP të LDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Daut Haradinaj - në emër të GP të AAK-së, Haxhi Shala - në emër të GP NISMA, Kujtim Paçak - në emër të GP “6+”, si dhe, Nenad Rashiq, Selvije Halimi, Armend Zemaj dhe Albulena Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi hodhi në votim propozimin e deputetes Albulena Haxhiu, në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje,” për shtyrjen e kësaj pike të rendit të ditës për seancën e radhës.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash nuk e miratoi propozimin e deputetes Albulena Haxhiu.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim miratimin e propozimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 51,
Kundër----- 15,

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

I. Anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës emërohen:

1. Nehat Idrizi, nga Gjykata Themelore në Prishtinë,
2. Armend Berisha, nga Gjykata Themelore në Pejë dhe
3. Gjimshit Galushi, nga Gjykata Themelore në Prizren.

II. Mandati i të emëruarve nga pika **I** e këtij vendimi zgjat pesë (5) vjet.

5. Propozimi për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Deputetja Albulena Haxhiu, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, tha se si Komision e kemi shqyrtuar propozimin për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit ia kemi rekomanduar emërimin e tij. Fjala e znj. Albulena Haxhiu është dhënë e plotë në transkript.

Kryesuesi Sabri Hamiti e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Selvije Halimi - në emër të GP të PDK-së, Armend Zemaj - në emër të GP të LDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Donika Kadaj-Bujupi - në emër të GP të AAK-së, Haxhi Shala - në emër të GP NISMA, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve kryesuesi, hodhi në votim propozimin për emërimin e z. Rexhep Gashi – nga Fakulteti Juridik, Universiteti “Hasan Prishtina”, në Prishtinë, anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----52,
Kundër ----- 12
Abstenime ----- 6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

I. Anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës emërohet:

Prof. Rexhep Gashi, nga Fakulteti Juridik, Universiteti “Hasan Prishtina”, në Prishtinë.

II. Mandati i të emëruarit nga pika **I** e këtij vendimi zgjat dy (2) vjet.

6. Formimi i Komisionit Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës

Kryesuesi, Sabri Hamiti, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kërkoi nga grupet parlamentare që të propozojnë kryetarin, zëvendëskryetarët dhe anëtarët e Komisionit Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Fjala e nënkryetarit Sabri Hamiti, është dhënë e plotë në transkript.

Grupi Parlamentar Lista Serbe nuk ishte i pranishëm në sallë dhe rrjedhimisht nuk pati propozim nga ky grup.

Myfera Shinik, në emër të Grupi Parlamentar “6+”, deklaroi se ende nuk kanë vendosur për emrin e anëtarit të Komisionit ad-hoc.

Pas paraqitjes së propozimeve nga përfaqësuesit e grupeve të tjera parlamentare, kryesuesi hodhi në votim propozim për emërimin e Komisionit Ad-hoc.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 68,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaku, nga GP i PDK-së, kryesuese,
2. Albulena Haxhiu, nga GP i LVV-së, zv/kryesuese e parë,
3. Qerim Bajrami, nga GP “6+”, zv/kryesues i dytë,
4. Zenun Pajaziti, nga GP i PDK-së, anëtar,
5. Alma Lama, nga GP i LDK-së, anëtare,
6. Melihate Tërmkolli, nga GP i LDK-së, anëtare,
7. Pal Lekaj, nga GP i AAK-së, anëtar,
8. Zafir Berisha, nga GP Nisma për Kosovën, anëtar.
9. _____, nga GP i LS-së, anëtar/e,

II. Ngarkohet Komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të veprojë në përputhje me nenin 6 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryesuesi mbylli punimet e seancës plenare në orën 13 e 58 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale